



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:260906
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05502453

Ac.nr.8103/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve J.M., A.S., dhe K.K., që të gjithë nga Komuna Vushtrri, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson L.T., avokat se seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, në çështjen për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.561/2022 datë 03.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.561/2022 datë 03.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.561/2022 datë 03.11.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve J.M., A.S., dhe K.K. të gjithë nga Vushtrria.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të shujtave ditore për periudhën kohore 08.06.2020 e deri më 26.03.2021, paditësin J.M. ta kompensoj në shumë prej 348.00 euro, paditësin A.S., në shumë prej 270.00 euro dhe paditësen K.K. në shumë prej 254.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga 09.12.2022 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësve t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë, për padi shumë prej 208.00 euro në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm...”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa dhe të anulohet aktgjykimi dhe lëndën t'ia kthej rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë kanë paraqitur paditësit me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit J.M., A.S., dhe K.K., që të gjithë nga Komuna Vushtrri, me datë 09.12.2022, kanë ushtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri.

Gjykata e shkallës së parë me datë 03.11.2023, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.561/2022 datë 03.11.2023, me të cilin ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar si vijon: “...gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve J.M., A.S., dhe K.K. si punëtorë të arsimit t'ua paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozita e lart cituar e KKAK-së, dhe bazuar në nenin 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë se nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë paditësi J.M. është punëtor teknik në SHFMU “Nazmi Zhegrova” në ...komuna e Vushtrrisë, ku vërtetohet në bazë të kontratës së punës e lëshuar nga DKA-Vushtrri me datë 18.01.2018 me numër 45/20 si dhe nga vërtetimi i lëshuar i datës 26.03.2021 me numër ref. 27, nga SHFMU “Nazmi Zhegrova” në ...komuna e Vushtrrisë, vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria në punë e paditësit nga data 08.06.2020 deri me datë 26.03.2021, periudhë për të cilën paditësi kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, është gjithsejtë 174 ditë. Paditësi A.S., është mësimdhënës në SHFMU “Nazmi Zhegrova” në ...komuna e Vushtrrisë, nga kontrata e punës e lëshuar nga DKA-Vushtrri me datë 29.09.2015 me numër 638/20 si dhe nga vërtetimi i lëshuar i datës 26.03.2021 me numër ref. 17, nga SHFMU “Nazmi Zhegrova” në ...komuna e Vushtrrisë, vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria në punë e paditësit nga data 08.06.2020 deri me datë 26.03.2021, periudhë për të cilën paditësi kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, është gjithsejtë 135 ditë. Paditësja K.K. është mësimdhënëse në SHFMU “Nazmi Zhegrova” në ...komuna e Vushtrrisë, nga kontrata e punës e lëshuar nga DKA-Vushtrri me datë 06.12.2017 me numër 191/20 si dhe nga vërtetimi i lëshuar i datës 26.03.2021 me numër ref. 28, nga SHFMU “Nazmi Zhegrova” në ...komuna e Vushtrrisë, vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria në punë e paditëses nga data 08.06.2020 deri me datë 26.03.2021, periudhë për të cilën paditësja kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, është gjithsejtë 127 ditë, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Lidhur me shumën e kompensimit të ushqimit në punë, Gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *“...Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*, e cila Kontratë është lidhur dhe është nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Kulturës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, dhe e datës 22.01.2021, andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar

kërkesëpadinë e paditëseve si të bazuar në tërësi, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve"*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes"*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës"*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive"*.

Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar të drejtën materiale lidhur me afatshmërinë e padisë, gjegjësisht se kërkesa e paditësve nuk është parashkruar, për shkak se në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, me nr. 03/L-212 i dt. 01.11.2010, përcaktohet se: *"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës"* duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe e cila ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, rrjedh se padia e paditësve është e lejuar dhe e ushtruar brenda afatit kohor.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8103/2023 datë 25.03.2024

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi**